

Të dashurit e Perëndisë,  
Vëllezër dhe motra të shtrenjtë!

Me kënaqësi të madhe komuniteti im dhe unë ju ofrojmë tekstet në vijim që flasin për parimet bazë, “gurët e ndërtimit”, të jetës së Krishterë Ortodokse. Vetë tekstet janë përkthime të bëra nga Shquarsia e Tij, Joani, Metropolitan i Korçës, dhe ne jemi mirënjohës për bekimin e tij që i riprodhoi ato këtu për edukimin tuaj.

(Ju lutem vendosni çdo “kapitull” në kollone, duke e nënvizuar për lidhje kryesore)

Tekstet origjinale vijnë nga një seri librash të botuar në anglisht nga Protopresbiteri Thomas Hopko, ish kujdestar i Seminarit Teologjik Ortodoks Shën Vladimir, dhe dikur pastor i Kishës Ortodokse Shqiptare së Shën Nikollës në Xhamaika, Kuins, Nju Jork.

Komuniteti ynë u themelua në 1925 nga një grup emigrantësh shqiptarë dhe që nga ajo kohë ne ia kemi përkushtuar veten tonë shpalljes së lajmit të Krishtit. Ndërkohë që më tepër se gjysma e komunitetit tonë është me origjinë shqiptare, ne kemi mirëpritur dhe shumë kombësi të tjera të adhurojnë me ne. Ne gjithashtu ju ftojmë dhe juve të vini për vizitë, apo për të qëndruar.

Për më tepër informacion për Kishën Ortodokse, ju ftojmë të vizitoni faqen zyrtare të Kishës Ortodokse në Shqipëri:

[Orthodoxalbania.org](http://Orthodoxalbania.org)

Me dashuri në Krishtin

Kryepriift Sergei C. Bouteneff, pastor  
Kisha Ortodokse Shqiptare e Shën Gjergjit